



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Datë: 07.04.2025

Numër Protokolli: 2302/2025

A.nr.347/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani-Kryetar, Ardita Haxhnikaj Demi dhe Malsore Gashi Bajraktari-anëtarë, me Çlirim Zeka-në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.347/2025, të datës 21.02.2025, të parashtruar nga ankuesi B.M, kundër organit të punësimit Agjencia e Zhvillimit të Bujqësisë, në çështjen juridike “*Kontestim Konkursi*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.2 dhe 1.6 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180 si dhe në mbështetje me dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 07.04.2025, mori këtë:

V E N D I M

I. Aprovohet si e bazuar ankesa me numër A.nr.347/2025 e datës 21.02.2025 e parashtruar nga ankuesi B.M, ashtu që, **Anulohet** Njoftimi me numër protokolli 571 i datës 27.01.2025, i Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Agjencinë për Zhvillimin e Bujqësisë, si dhe të gjitha veprimet administrative të ndërmarra nga Komisioni i Pranimit i themeluar sipas Vendimit, me numër protokolli 01-11322 të datës 31.12.2024 të Drejtorit Ekzekutiv të Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë, ndërsa, çështja kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje duke filluar nga testimi me shkrim dhe intervista verbale.

II. Obligohet Drejtori Ekzekutiv i Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë, që brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimit të tij, duke themeluar Komisionin ri të Pranimit në pajtim me nenin 45 paragrafi 2 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, ndërsa, ky i fundit obligohet të zhvilloj procedurën e vlerësimit profesional të kandidateve të përfshirë në listën-njoftimin e datës 30.12.2024, në pajtim me legjislacionin e aplikueshëm që rregullon procedurën e pranimit në shërbim civil.

III. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Kandidati për pranim në shërbimin civil B.M (në tekstin e mëtejme referuar: ankuesi), me datë 21.02.2025 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 1169/2025 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me pretendimin ankimor lidhur me konkursin për pozitën Udhëheqës i Divizionit për Burime Njerëzore në Agjencinë për Zhvillimin e Bujqësisë në kuadër të Ministrisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, i njëjti thekson se ka pasur shkelje të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik dhe Rregullores Nr.15/2023 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, anëtarët e Komisionit të pranimin të cilët kanë marrë pjesë në këtë procedurë janë në kundërshtim me nenin 45 të LZP, kërkon të anulohet konkursi.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 04.03.2025 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë, ndërsa Këshilli më datë 11.03.2025, ka pranuar përgjigje në ankesë nga Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokolli 1169/2025 të datës 21.02.2025 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Diplomë nga Universiteti i Prishtinës Hasan Prishtina për B.M. me numër nr.1888 i datës 22.10.2018; Testi Individual i B.M. i datës 09.01.2025; Njoftim i Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore i Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë i datës 30.12.2024; Lista e aplikantëve; Diplomë nga Universiteti i Prishtinës për B.M. me numër nr.915 i datës 15.06.2010; Letërnjoftim i B.M.; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2023 i B.M. i datës 12.12.2023; Vërtetim i Burimeve Njerëzore për B.M. i datës 08.03.2024; Vërtetim nga Drejtoria e Financave dhe Pronës për B.M. i datës 05.05.2011; Marrëveshje për praktikë në punë për B.M. i datës 29.01.2016; Marrëveshje për praktikë në punë për B.M. i datës 29.07.2016; Marrëveshje për praktikë në punë për B.M. i datës 01.02.2017; Marrëveshje për praktikë në punë për B.M. i datës 14.02.2017; Letër rekomandim nga E.B. për B.M. i datës 28.03.2018; Pasqyra e llogarisë së trustit e B.M. i datës 01.08.2002-08.04.2024; E-mail nga B.M. për ankesa.kpmshck@rks-gov.net i datës 21.02.2025; E-mail nga ankesa.kpmshck@rks-gov.net për B.M. i datës 21.02.2025; Kërkesë për përgjigje në ankesë i datës 04.03.2025; Përgjigje në ankesë i datës 11.03.2025; Konkursi për pozitën Udhëheqës i Divizionit për Burime Njerëzore në Agjencinë për Zhvillimin e Bujqësisë në kuadër të Ministrisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural me numër reference RN00015795 i datës 15.11.2024; Renditja përfundimtare e kandidatëve i simbnj i datës 27.01.2025; Njoftim për kandidatin fitues Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore i Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë i datës 27.01.2025; E-mail nga A.K. për E.B. i datës 05.12.2024; Aplikacioni i B.M. i datës 07.12.2024; Diplomë për kryerjen e shkollës së mesme profesionale i B.M. me numër protokolli 1298/1 i datës 09.06.2003; Certifikatë nga zas trade për B.M. i datës 21.03.2005; Kontratë nga MBPZHR për B.M. i datës 09.03.2021; Certifikatë mbi dënimet penale i B.M. i datës 12.04.2024; Certifikatë nga Organika për B.M. i datës 25.11.2021; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2022 i B.M. i datës 08.02.2023; Aplikacioni i M.B. i datës 26.11.2024; Diplomë nga Kolegji AAB për M.D. me numër nr.1171/18 i datës 16.07.2018; Certifikatë nga Akademia profesionale elita për M.B. i datës 27.03.2017; Certifikatë themelore profesionale për prokurim e M.B. me numër 898 për vitin 2022-2024; Certifikatë nga Ikap për M.B. e muajit Janar 2023; Certifikatë nga

Ikap për M.B. e muajit Tetor 2023; Kontratë pune nga Ardi shped Gjakovë për M.D. i datës 01.01.2014; Marrëveshje për praktikë në punë i M.B. i datës 01.02.2017; Marrëveshje për praktikë në punë i M.B. i datës 24.07.2017; Marrëveshje për angazhim në masën aktive të tregut të punës i M.D. i datës 30.04.2018; Marrëveshje për angazhim në masën aktive të tregut të punës i M.D. i datës 01.11.2018; Vendim për emërimin e asistentes të Ministres i MBPZHR i datës 26.02.2019; Akt Emërim i M.D. i datës 18.10.2019; Vendim i U.d. Sekretarit të Përgjithshëm të MBPZHR për M.D. me numër protokolli 1980/2 i datës 22.05.2020; Akt Emërim i M.B. i datës 30.03.2023; Vendim i U.d. Drejtorit Ekzekutiv të AZHB për M.B. i datës 17.09.2024; Referencë nga A.B. për M.B. e vitit 2018; Letër reference nga Ardi shped për M.D. e muajit Dhjetor 2016; Letërnjoftim i M.B.; Vërtetim nga U.d. Drejtorit Ekzekutiv të AZHB për M.B. i datës 20.11.2024; Deklaratë nën betim e M.B. i datës 20.11.2024; Pasqyra e llogarisë së trustit e M.D. i datës 01.08.2002-09.12.2024; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civil dhe nëpunësve të shërbimeve publike për kategorinë drejtues i mesëm i ulët dhe profesional i M.B. i datës 31.01.2024; Vendim i Drejtorit Ekzekutiv të AZHB për themelimin e komisionit të pranimit me numër protokolli 11322 i datës 31.12.2024; Akt Emërim i F.D. i datës 12.11.2018; Akt Emërim i L.B. i datës 06.12.2012; Akt Emërim i A.R. i datës 18.10.2023; Vendim i zv. Drejtorit Ekzekutiv të AZHB për A.R. i datës 09.02.2024; Ndryshim dhe plotësim i akt emërimit për A.H. i datës 08.06.2018; Akt Emërim i I.M. i datës 12.01.2017; Vendim i zv. Kryeshefes Ekzekutive të AZHB për I.L. i datës 13.08.2021; Akt Emërim i I.L. i datës 20.11.2012; Formular i vlerësimit të përgjithshëm të esesë së kandidatit nga komisioni i pranimit kodi CN3994 i datës 17.01.2025; Formular i vlerësimit të përgjithshëm të esesë së kandidatit nga komisioni i pranimit kodi CN2307 i datës 17.01.2025; Formular i vlerësimit të përgjithshëm të esesë së kandidatit nga komisioni i pranimit kodi CN5266 i datës 17.01.2025; Formular i vlerësimit të përgjithshëm të esesë së kandidatit nga komisioni i pranimit kodi CN5462 i datës 17.01.2025; Formular i vlerësimit të përgjithshëm të esesë së kandidatit nga komisioni i pranimit kodi CN4486 i datës 17.01.2025; Formular i vlerësimit të përgjithshëm të esesë së kandidatit nga komisioni i pranimit kodi CN1851 i datës 17.01.2025; Formular i vlerësimit individual të anëtarit të komisionit për kandidatin në intervistë nga F.D. për B.M. i datës 23.01.2025; Formular i vlerësimit individual të anëtarit të komisionit për kandidatin në intervistë nga L.A. për B.M. i datës 23.01.2025; Formular i vlerësimit individual të anëtarit të komisionit për kandidatin në intervistë nga I.L. për B.M. i datës 23.01.2025; Formular i vlerësimit individual të anëtarit të komisionit për kandidatin në intervistë nga A.N. për B.M. i datës 23.01.2025; Formular i vlerësimit individual të anëtarit të komisionit për kandidatin në intervistë nga I.M. për B.M. i datës 23.01.2025; Vendim për autorizim i AZHB me numër protokolli 10469/2 i datës 10.12.2024; Formular i vlerësimit individual të anëtarit të komisionit për kandidatin në intervistë nga F.D. për M.B. i datës 23.01.2025; Formular i vlerësimit individual të anëtarit të komisionit për kandidatin në intervistë nga L.A. për M.B. i datës 23.01.2025; Formular i vlerësimit individual të anëtarit të komisionit për kandidatin në intervistë nga I.L. për M.B. i datës 23.01.2025; Formular i vlerësimit individual të anëtarit të komisionit për kandidatin në intervistë nga A.N. për M.B. i datës 23.01.2025; Formular i vlerësimit individual të anëtarit të komisionit për kandidatin në intervistë nga I.M. për M.B. i datës 23.01.2025;

Kolegji i Këshillit duke u bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veç e veç dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, ka gjetur se ankesa e ankuesit, është e bazuar, **sepse:**

Kolegji i Këshillit nga administrimi i shkresave të lëndës ka gjetur se Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë në kuadër të Ministrisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, më datë 15.11.2024 ka shpallë Konkursin me numër reference RN00015795 për pozitën Udhëheqës i Divizionit për Burime Njerëzore klasa e pozitës Drejtues i Ulët, ku afati për aplikim ka qenë nga data 16.11.2024 deri më 15.12.2024.

Tutje, nga shkresat e lëndës rezulton se në këtë konkurs ka aplikuar edhe ankuesi me datë 07.12.2024 i cili e ka kaluar fazën e verifikimit paraprak duke plotësuar kriteret e konkursit dhe se i është nënshtruar fazës së testimit me shkrim të mbajtur me datë 09.01.2025, ku në testin me shkrim për pozitën Udhëheqës i Divizionit për Burime Njerëzore në Agjencinë për Zhvillimin e Bujqësisë ka marrë gjithsejtë 55.4 pikë nga rrjedh se ankuesi ka marrë pikët e mjaftueshme për t'iu nënshtruar fazës tjetër të vlerësimit gjegjësisht vlerësimit të intervistës me gojë i cili në intervistë ka marrë gjithsejtë 24 pikë. Ndërsa sipas renditjes përfundimtare të kandidatëve del se ankuesi ka marrë pikët totale gjithsejtë 79.4 pikë për pozitën Udhëheqës i Divizionit për Burime Njerëzore në Agjencinë për Zhvillimin e Bujqësisë duke u renditur i dyti.

Ndërsa sipas shkresave të lëndës rezulton në këtë konkurs ka aplikuar kandidatja M.B. me datë 26.11.2024 e cila e ka kaluar fazën e verifikimit paraprak duke plotësuar kriteret e konkursit dhe se i është nënshtruar fazës së testimit me shkrim të mbajtur me datë 09.01.2024, ku në testin me shkrim për pozitën Udhëheqës i Divizionit për Burime Njerëzore në Agjencinë për Zhvillimin e Bujqësisë ka marrë gjithsejtë 58.8 pikë nga rrjedh se ka marrë pikët e mjaftueshme për t'iu nënshtruar fazës tjetër të vlerësimit gjegjësisht vlerësimit të intervistës me gojë e cila në intervistë ka marrë gjithsejtë 28.6 pikë. Ndërsa sipas renditjes përfundimtare të kandidatëve del se ka marrë pikët totale gjithsejtë 87.4 pikë për pozitën Udhëheqës i Divizionit për Burime Njerëzore në Agjencinë për Zhvillimin e Bujqësisë duke u renditur e para.

Ndërsa Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Agjencinë për Zhvillimin e Bujqësisë me datë 27.01.2025 me numër protokolli 571 ka publikuar Njoftimin për kandidatin fitues për pozitën Udhëheqës i Divizionit për Burime Njerëzore në Agjencinë për Zhvillimin e Bujqësisë për kandidaten M.B. me gjithsejtë 87.40 pikë.

Ankuesi ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me pretendimin ankimor lidhur me konkursin për pozitën Udhëheqës i Divizionit për Burime Njerëzore në Agjencinë për Zhvillimin e Bujqësisë në kuadër të Ministrisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, i njëjti thekson se ka pasur shkelje të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik dhe Rregullores Nr.15/2023 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, anëtarët e Komisionit të pranimit të cilët kanë marrë pjesë në këtë procedurë janë në kundërshtim me nenin 45 të LZP, kërkon të anulohet konkursi.

Kolegji i Këshillit, në përmbushje të mandatit të tij kushtetues dhe ligjor për sigurimin e respektimit të rregullave dhe parimeve në shërbimin civil, fillimisht ka analizuar aktin e themelimit të Komisionit të pranimit, gjegjësisht vendimin me numër protokolli 11322 të datës 31.12.2024 nga analizimi i të cilit ka gjetur se Komisioni i pranimit për pozitën e kategorisë Drejtues i Ulët për pozitën Udhëheqës i Divizionit për Burime Njerëzore është në përbërje prej pesë (5) anëtarëve, Kryetare F.M. në pozitën e punës Menaxhere Personelit në Divizionin e Burimeve Njerëzore në MBPZHR, anëtarja L.B., në pozitën e punës Shefe e Divizionit për komunikim me publikun në Divizionin për Komunikimi me Publikun në MBPZHR, anëtari I.L. në pozitën e punës zëvendësues i përkohshëm i Drejtorit të Drejtorisë së Pagesave Direket në AZHB, anëtari (anëtar zëvendësues) A.N. në pozitën e punës Drejtor i Drejtorisë për Autorizimin e Pagesave në AZHB dhe anëtari I.M. në pozitën e punës Zyrtare i Teknologjisë Informative në AZHB. Kolegji i Këshillit konstaton se pozita Udhëheqës i Divizionit për Burime Njerëzore, klasifikohet si kategori e ulët drejtuese që përfshin pozitën e udhëheqëses/it të divizionit dhe pozitën e barasvlershme me të, siç përcaktohet me nenin 38 paragrafi 2 nën paragrafi 2.3 të Ligjit Nr.08/L-197 për

Zyrtarët Publik, andaj edhe Komisioni i pranimit duhet të jetë në përbërje siç kërkohet me nenin 45 paragrafi 1 dhe 2 të këtij ligji ku përcaktohet se: *1. Vlerësimi profesional i kandidateve/ëve për emërimin në një pozitë të kategorisë së ulët dhe të mesme drejtuese në administratën shtetërore bëhet nga komisioni i pranimit. 2. Komisioni i pranimit për pozita të kategorisë së ulët dhe të mesme drejtuese, ka pesë (5) anëtare/ë, në këtë përbërje: 2.1. tre (3) nëpunëse/ës civil ekzistues të kategorisë së njëjtë apo më të lartë; 2.2. një (1) nëpunëse/ës civil nga njësia përgjegjëse; dhe 2.3. një (1) nëpunëse/ës civil me njohuri në fushën e pozitës së lirë..., dhe si rrjedhojë bazuar në kuadrin përkatës ligjor, si dhe shqyrtimi dhe analizimi i provave të lëndës, Kolegji ka gjetur se përbërja e komisionit të pranimit në procedurën përkatëse të rekrutimit nuk ka qenë në pajtim me kërkesat ligjore.*

Kolegji i Këshillit, duke marr për bazë nenin 86 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ku përcaktohet se ***“Organi publik detyrohet, sipas detyrës zyrtare, të shqyrtojë të gjitha faktet dhe të vlerësojë të gjitha rrethanat e nevojshme për zgjidhjen e çështjes administrative. 2. Organi publik përcakton, në mënyrë të pavarur, llojin dhe shtrirjen e shqyrtimit administrativ, si dhe vlerëson nëse një fakt apo rrethanë është e nevojshme për zgjidhjen e çështjes”***, ka konstatuar se Komisioni i Pranimit është themeluar në kundërshtim me nenin 35 paragrafi 3, 4 dhe 5 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, i cili përcakton se: *3. Zyrtarja/i publik nuk mund të caktohet si ushtruese/i detyre më gjatë se gjashtë (6) muaj. Kur pozita nuk mund të plotësohet brenda afatit gjashtë (6) muaj, ky afat mund të zgjas më së shumti edhe për gjashtë (6) muaj të tjerë. 4. Pozita e lirë nuk mund të zëvendësohet me ushtrues detyre për më gjatë se afati i përcaktuar në paragrafin 3. të këtij neni. 5. Çdo vendim i marrë nga ushtruesja/i i detyrës, pas kalimit të afatit të përcaktuar në paragrafin 3. të këtij neni, është i paligjshëm..., ngase në komision është caktuar një anëtarë I.L. i cili është caktuar zëvendësues i përkohshëm i Drejtorit të Drejtorisë së Pagesave Direket në Agjencinë për Zhvillimin e Bujqësisë. Kolegji i Këshillit ka konstatuar se i njëjti është caktuar sipas vendimit me numër protokolli 5402 të datës 13.08.2021 të zv.Kryeshefes Ekzekutive të Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë.*

Andaj, referuar konstatimeve si më sipër dhe bazuar në paragrafin 1 dhe 2 të nenit 45 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, ku përcaktohet se: *1. Vlerësimi profesional i kandidateve/ëve për emërimin në një pozitë të kategorisë së ulët dhe të mesme drejtuese në administratën shtetërore bëhet nga komisioni i pranimit. 2. Komisioni i pranimit për pozita të kategorisë së ulët dhe të mesme drejtuese, ka pesë (5) anëtare/ë, në këtë përbërje: 2.1. tre (3) nëpunëse/ës civil ekzistues të kategorisë së njëjtë apo më të lartë; 2.2. një (1) nëpunëse/ës civil nga njësia përgjegjëse; dhe 2.3. një (1) nëpunëse/ës civil me njohuri në fushën e pozitës së lirë.*, Kolegji i Këshillit, konstaton se përbërja e Komisionit të Pranimit, e themeluar sipas Vendimit me numër protokolli 11322 të datës 31.11.2024 të Drejtorit Ekzekutiv të Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë ka qenë në kundërshtim me dispozitat përkatëse ligjore, sepse caktimi i anëtarëve të Komisionit përkatës është realizuar përmes shkeljeve të dispozitave ligjore të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, ngase në përbërje të komisionit të pranimit për vlerësimin profesional të kandidateve është caktuar një anëtarë I.L. i cili është caktuar zëvendësues i përkohshëm i Drejtorit të Drejtorisë së Pagesave Direket në Agjencinë për Zhvillimin e Bujqësisë sipas vendimit me numër protokolli 5402 të datës 13.08.2021 të zv.Kryeshefes Ekzekutive të Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë dhe nuk ka mandat të jetë pjesë e komisionit të pranimit.

Si rrjedhojë e konstatimeve si më sipër dhe duke ju referuar dispozitave të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, përkatësisht nenit 4, ku përcaktohet se: *“1. Organet publike veprojnë në përputhje me Kushtetutën, legjislacionin në fuqi, si edhe me rregullat e përgjithshme*

administrative të zbatueshme brenda kompetencave të tyre dhe në përputhje me qëllimin për të cilat janë dhënë këto kompetenca. 2. Veprimi administrativ që cenon apo mund të cenojë një të drejtë apo interes juridik të një personi, duhet të jetë i autorizuar nga një ligj”, si dhe nenin 52, ku përcaktohet se: “1.Një akt administrativ është i paligjshëm nëse: 1.1. është nxjerre në mungesë të autorizimit nga një ligj, sipas paragrafit 2 të nenit 4 të këtij Ligji; 1.2. organi publik që e nxjerr ka vepruar pa pasur kompetencë; 1.3. është rezultat i shkeljes të dispozitave lidhur me procedurën administrative”. Kolegji i Këshillit, konstaton se Vendimi me numër protokolli 11322 i datës 31.12.2024 i Drejtorit Ekzekutiv të Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë, për themelimin e Komisionit të Pranimit për procedurën e rekrutimit me numër reference RN00015795, është i pa ligjshëm në kuptim të nenit 4 dhe nenit 52 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, për faktin se Komisioni i pranimit nuk ka kompetencë ligjore për ushtrimin e këtyre pozitave drejtuese të caktuar sipas vendimit të lartë theksuar dhe rrjedhimisht vlerësimin profesional të kandidatëve për pozitën e punës Udhëheqës i Divizionit për Burime Njerëzore në Agjencinë për Zhvillimin e Bujqësisë.

Andaj, bazuar si më sipër, Kolegji i Këshillit, konstaton se pretendimi ankimor i ankuesit është i bazuar, ashtu që me qëllim të vendosjes së ligjshmërisë si dhe në kuptim nenit 7 paragrafi 1 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrat Publik, ku është përcaktuar se: “1.Pranimi në detyrë i **nëpunëses/it civil**, nëpunëses/it së shërbimit publik, krijueses/it dhe performueses/it së artit dhe kulturës, si dhe nëpunëses/it teknik dhe mbështetës, bazohet në parimin e meritës, e mundësive të barabarta, **profesionalizmit** dhe integritetit, mos diskriminimit dhe përfaqësimit të drejtë dhe të barabartë gjinor dhe të komuniteteve, përmes një procedure të hapur dhe konkurruese”, dhe duke qenë se Komisioni i Pranimit për vlerësimin e kandidateve në procedurën e rekrutimit më numër Reference RN00015795, nuk është emëruar në pajtim me ligjin material, atëherë, në vlerësimin e Kolegjit të Këshillit, çdo veprim administrativ i ndërmarr nga Komisioni i Pranimit konsiderohet juridikisht i pavlefshëm në kuptim të nenit 52 paragrafi 1.1, 1.2 dhe 1.3 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, rrjedhimisht, Kolegji vendosi që të aprovoj ankesën si të bazuar, të anuloi njoftimin e datës 27.01.2025, të Njësisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore të Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë në kuadër të Ministrisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, lidhur më ndërprerjen e procedurës së pranimit më numër Reference RN00015795 si dhe të gjitha veprimet administrative të ndërmarra nga Komisioni i Pranimit, ndërsa, çështja kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje në fazën e vlerësimit profesional, duke obliguar Drejtorin Ekzekutiv të Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë, që në afat kohor sikurse është përcaktuar në pikën II të dispozitivit, të themeloj Komisionin e ri të Pranimit për pozitën e kategorisë Drejtues i Ulët pozita Udhëheqës i Divizionit për Burime Njerëzore, në pajtim me kërkesat ligjore të përcaktuara me nenin 45 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrat Publik, ndërsa, ky i fundit obligohet të zhvillojë procedurën e vlerësimit profesional të kandidatëve të përfshirë në listën–njoftimin e datës 30.12.2024, në pajtim me legjislacionin e aplikueshëm që rregullon procedurën e pranimit në shërbim civil.

Kështu që pas analizimit dhe vlerësimit të shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar nenin 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1, nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 dhe 1.6 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe nenin 132 paragrafi 4 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.347/2025

Çlirim Zeka

Procesmbajtës

Eshref Shabani

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit B.M;
- Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë (Drejtorit Ekzekutiv dhe Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore); si dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.